



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL. Anr.198/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Violeta Husaj Rugova - kryesuese, Hajriz Hoti dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Pejë, parashtruar kundër subjektit politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK) me seli në Pejë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2025, të datës 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 13.10.2025, merr këtë :

V E N D I M

I. Pranohet si e bazuar ankesa e subjektit politik, Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Pejë, ZL.Anr.198/2025 e datës 11.10.2025.

II. Subjektit politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), me seli në Pejë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 3,000.00€ (tre mijë euro).

III. Detyrohet Subjekti politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

IV. Urdhërohet kryetari i subjektit politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), Elbert Krasniqi që nga momenti i marrjes së këtij vendimi ta largojë postimin e datës 10.10.2025, të bërë në profilin e tij ne rrjetin social Facebook, përndryshe mosbindja ndaj kësaj urdhërese paraqet shkelje tjetër të këtij ligji që mund të sanksionohet me dënime shtesë nga PZAP-i.

A r s y e t i m

Me datë 11.10.2025 ne PZAP-i, është parashtruar ankesë nga subjekti politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), në të cilën pretendohet kryetari i Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës- (IRDK), Elbert Krasniqi, më datën 10.10.2025 në profili e tij në facebook ka theksuar " Në audioincizimin e publikuar nga RTK, dëgjohet Fatmir Sheholli duk biseduar me një grua. "

Për çudi, në atë bisedë përmendet edhe një deputet nga radhët e komuniteteve m emrin "Veton". A thua pse? A thua për çfarë bëhet fjalë ? Kujtojmë se Fatmir Sheholli u arrestua dje për spiunazh". Sipas parashtruesit të ankesës me këtë postim në facebook, Elbert Krasniqi, ka cënuar rëndë procesin zgjedhor, kështu duke tentuar që ta njolloso emrin e deputetit Veton Berisha nga komuniteti egjiptian, me skandalin e fundit të dyshuar për shpiunazh Fatmir Sheholli, duke lënë përshtypjen tek votuesit se kinse unë Veton Berisha kam qenë i lidhur apo përfshirë në dukuri negative. Kështu duke ngritur dyshime tek votuesit e Partisë Liberale Egjiptiane (PLE), se për çfarë bëhet fjalë në këto komunikime, ku postimi i Elbert Krasniqit është pëlqyer nga më shumë se 180 veta, është komentuar nga komentues të ndryshëm, duke bërë nxitje dhe përçarje të votuesit të PLE-së. Edhe pse ky komunikim dyshohet se është bërë në vitin 2019, Elbert Krasniqi, me postimin e tij në facebook ka synuar që të votuesit ta ndërlidhë Veton Berishën kinse edhe ky i fundit është i përfshirë në spiunazh ku qëllimi i Elbert Krasniqi ka qenë të dëmtoj procesin zgjedhor në të cilin jemi dhe kur dihet se jemi në fushatë zgjedhore për zgjedhjet e 12 Tetor 2025.

Parashtruesi i ankesës me tej thekson se me këtë postim, Elbert Krasniqi ka bërë shkelje të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, i detyron gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politike të jenë në një atmosferë të tolerancës, demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit. Vlen të theksohet se ky postim është i ndjeshëm dhe përbën rrezik për të nxitur votuesit të PLE-së. Gjuha e përdorur në profilin e tij në facebook, në diskursin publik të kryetarit të IRDK-së, Elbert Krasniqi si publikimi i shpërndarë në facebook nga shume kandidatë dhe anëtarë të IRDK-se, fakti që kjo deklarate është shpërndarë në rrjete sociale, përdorimi i një gjuhë të tillë me qëllim njolloshjen me rastin e fundit të Fatmir Sheholli, kështu duke shkelur etikën zgjedhore, legjislacionin zgjedhor si dhe standardet e sjelljes në fushatën zgjedhore. Fushata zgjedhore duhet të zhvillohet në një ambient të ndershëm dhe të drejtë, duke respektuar subjektet politike rivale dhe se postimi i Elbert Krasniqit me qëllim dëmtimin dhe imazhit të Partisë Liberale Egjiptiane dhe mbështetësit të saj, duke shkelur parimet e një fushate të respektueshme dhe se të tilla postimet dhe deklaratimet e Elbert Krasniqit duhen të dënohen nga ana e juaj. Si dëshmi ka bashkangjitur CD dhe foto.

Në përgjigje në ankesë të subjekti politik IRDK përmes kësaj përgjigjeje, paraqet qëndrimin e tij, duke mohuar në tërësi pretendimet e ngritura, duke theksuar se Elbert Krasniqi nuk ka bërë asnjë pohim që lidhë drejtpërdrejt Veton Berishën me rastin e të dyshuarit për spiunazh, postimi i datës 10.10.2025 përmban pyetje publike: “Në audio incizimin e publikuar nga RTK dëgjohet Fatmir Sheholli duke biseduar me një grua. Për çudi, në atë bisedë përmendet edhe një deputet nga radhët e komuniteteve me emrin 'Veton'. A thua pse? A thua për çfarë bëhet fjalë?”, Ky formulim, në mënyrë të qartë, nuk përmban konstatim apo akuzë, por një pyetje retorike e cila lidhet me informacionin tashmë të publikuar nga RTK, pra me një temë tashmë në qarkullim publik, për të cilën qytetarët kishin njohuri paraprake. Në asnjë rast Elbert Krasniqi nuk ka thënë apo nënkuptuar se Veton Berisha është i përfshirë në ndonjë aktivitet të paligjshëm. Si rrjedhojë, nuk mund të ekzistojë cenim i procesit zgjedhor, përderisa postimi nuk përmban deklarata të pavërteta apo fakte të fabrikuara dhe as nuk lidhet

në asnjë kuptim me procesin zgjedhor. Koha e publikimit të këtij postimi përkon me kohën reale të raportimit të gjerë të mediave për rastin e Fatmir Shehollit dhe incizimin e përmendur. Më tutje ne përgjigje ne ankese theksohet se si figurë politike, Elbert Krasniqi ka të drejtë të shprehë interes publik dhe të ngrejë pyetje që ndihmojnë transparencën, sidomos kur bëhet fjalë për çështje që përfshijnë komunitetet jo-shumicë dhe përfaqësuesit e tyre. Pyetjet publike nuk mund të interpretohen si shpifje apo si "tentim për njollosje", nëse ato nuk përmbajnë akuza eksplicite, por janë pjesë e debatit demokratik në një shoqëri demokratike e pluraliste. Përmbajtja e postimit nuk përmban elemente të shkeljes së legjislacionit zgjedhor. Postimi nuk përmban asnjë element të fushatës zgjedhore, qoftë përmendje të numrit zgjedhor të ndonjërit subjekt politik, kërkesë për votim apo mos-votim, promovim apo denigrim. Në artikullin e Gazeta Express, me titull "Duda Balje për inçizimin me Shehollin që e publikoi RTK: I vjetër 6 vjet, s'ka deputet nga komunitetet që s'ka folur me të", deputetja Balje sqaron se çdo deputet nga komunitetet ka pasur komunikim me Shehollin, që nënkupton se edhe Veton Berisha. Kjo deklaratë dëshmon se përmendja e emrit "Veton" në incizim nuk ka domosdo kuptim inkriminues, por është pjesë e një konteksti më të gjerë komunikimi mes anëtarëve të komuniteteve dhe një personi publik, që patjetër është në interes të opinionit publik dhe vet komunitetit (egjiptian) përfaqësues të të Cilit është Veton Berisha, siç edhe Elbert Krasniqi. Rrjedhimisht, edhe nëse Elbert Krasniqi e ka përmendur këtë fakt publik, nuk mund të interpretohet si përpjekje për dëmtim të reputacionit të Veton Berishës, por si pyetje legjitime publike brenda kontekstit të një ngjarjeje mediatike. Ankuesi nuk ofron dëshmi se nga ky postim ka ndodhur ndonjë dëm konkret apo i matshëm elektoral. Për më tepër, reagimet në rrjete sociale (pëlqime, komente etj.) nuk mund të konsiderohen prova për cenim të procesit zgjedhor, sepse janë pjesë e debatit publik, jo veprim institucional apo propagandë e ndaluar. Sipas parimit të proporcionalitetit dhe jurisprudencës së PZAP në raste të ngjashme, mos vërtetimi i dëmit real dhe mungesa e qëllimit keqdashës janë bazë e mjaftueshme për refuzimin e ankesës. Bazuar në argumentet e mësipërme, në dispozitat e Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Rregullores kërkojmë që PZAP të refuzojë si të pabazuar ankesën e paraqitur nga Veton Berisha, kryetar i Partisë Liberale Egjiptiane - PLE, kundër Elbert Krasniqit, kryetar i Iniciativës së Re Demokratike të Kosovës – IRDK, të konstatojë se postimi i bërë më datë 10.10.2025 nuk përbën shkelje të Kodit të Mirësjelljes dhe as të Rregullores Zgjedhore, përderisa përmbajtja e tij nuk përmban akuza, gjuhë urrejtjeje apo elemente të fushatës së ndaluar.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës-PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, gjeti se:

- *Ankesa është e bazuar*

Paneli, pas vlerësimit të shkresave të ofruara si provë materiale në ankesë, si dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga subjekti politik IRDK, konstaton se kryetari i subjektit politik IRDK Elbert Krasniqi, përmes llogarisë së tij në rrjetin social Facebook ka shkruajtur një postim: *Për çudi, në atë bisedë përmendet edhe një deputet nga radhët e komuniteteve m emrin "Veton". A thua pse? A thua për çfarë bëhet fjalë ? Kujtojmë se Fatmir Sheholli u arrestua dje për spiunazh*", paneli konstaton se postimi i till edhe pse përmend emrin Veton,

qëllimi i këtij postimi është kundërshtim kryetarit të subjektit politik PLE, Veton Berisha. Andaj paneli vlerësoj se ankesa është e bazuar, sepse përdorimi i një gjuhe të tillë është në kundërshtim me nenin 34 paragrafi 1, pika 1.11, të LZP-së, me të cilën përcaktohet, *“Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”*. Prandaj për Panelin një veprim i tillë i subjektit politik në fjalë është në kundërshtim me dispozitat e lartcekura.

Sipas Panelit, Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politike të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Gjuha e përdorur në rrjetin social Facebook, nga Elbert Krasniqi kryetar i subjektit politik IRDK, ndaj kryetarit të subjektit politik PLE në fushatë zgjedhore, dhe përdorimi i këtij postimi është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, ku janë të përcaktuara veprimet e ndaluara të subjekteve politike përkatësisht, neni 34 paragrafi 1, pika 1.11, të LZP-së, siç është cek edhe më lart.

Në këtë rast është marrë për bazë konteksti dhe qëllimi për të cilin është bërë shkrimi i postuar në rrjetin social Facebook, prandaj, sipas Panelit, përdorimi i gjuhës së tillë ka për qëllim nxitje të urrejtjes, dhe kjo shprehet me pas nga komentet e bëra nga komentues të ndryshëm në të njëjtin postim. Sipas vlerësimit të Panelit, rregullat që rregullojnë fushatën zgjedhore kërkojnë nga subjektet politike dhe përfaqësuesit e tyre të shmangin përdorimin e gjuhës fyese, denigruese dhe urrejtëse. Përdorimi i kësaj gjuhe nga Elbert Krasniqi kryetar i subjektit politik IRDK, sipas Panelit është shkelje e etikës zgjedhore dhe standardeve të sjelljes në fushatë zgjedhore. Sjellja e tillë minon procesin demokratik dhe promovimin e zgjedhjeve të lira e të drejta. Fushatat zgjedhore duhet të zhvillohen në një ambient të ndershëm dhe të drejtë, duke respektuar të drejtat dhe dinjitetin e të gjithë qytetarëve dhe grupeve shoqërore. Shprehjet që janë përdorur mund të krijojnë një atmosferë të pasigurt, duke shkelur kështu parimet e një fushate pozitive dhe të respektueshme. PZAP-i me rastin e shqiptimit të gjobës ka marrë për bazë kontekstin se deklarata është bërë në kohën e fushatës zgjedhore dhe se nxit dhunë dhe urrejtje politike.

Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes, dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes. Kjo konsiston në atë se subjekti politik IRDK ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësitë gjatë procesit të fushatës zgjedhore. Paneli me rastin e shqiptimit të gjobës ndaj subjektit politik IRDK si masë lehtësuese ka marrë për bazë faktin se ky subjekt me parë nuk është dënuar për përdorim të gjuhës së urrejtjes me parë gjatë kësaj fushate zgjedhore.

Paneli vlerëson se në rastin konkret kryetari i subjektit politik IRDK, Elbert Krasniqi duhet që ta largoj postimin nga rrjeti social facebook, të datës 10.10.2025, ndërsa dështimi për ta bërë këtë-për t'iu bindur kësaj urdhëresë të PZAP-it, brenda periudhës së përmendur në vendim, paraqet shkelje tjetër të këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP, ashtu siç është përcaktuar me nenin 120, par.2 të LZP.

Nga arsyet e theksuara me lartë, e në kuptim të nenit 33 par. 5, nenit 34 par.1 pika 1.1, neni 118 paragrafi 1, neni 120 paragraf 1 nën paragrafi 1.3, të Ligji Nr.08/L-228, dhe nenit 9 paragrafi 5 nën paragrafi 5.5 dhe nenit 13 paragrafi 2 të Rregullës 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.198/2025 më datën 13.10.2025

Kryesuese e Panelit,
Violeta Husaj Rugova



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 paragrafi. 4 të LZP-së.